



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 101

Tiranë – E premte, 12 korrik 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 10.7.2019	Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komonuelthit të Bahamas..... 7433
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 10.7.2019	Për dhënie ndihme financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi, për mbështetjen e funksionimit të këtij këshilli dhe të zyrës koordinuese të tij në Plavë..... 7433
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 10.7.2019	Për dhënie kontributi financiar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, për vënien në funksion të Qendrës Kulturore (Multifunkionale) të këtij këshilli në komunën e Bujanocit..... 7433
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 10.7.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 607, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e mjediseve të ndërtesës “Godina e inovacionit” në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)”, të ndryshuar... 7434
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 10.7.2019	Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit..... 7435
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 10.7.2019	Për miratimin e rregullave të hollësishme për procedurat në lidhje me garantimin e sigurisë në mjediset e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit..... 7436
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 10.7.2019	Për shkarkimin nga detyra të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve..... 7439

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 10.7.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 419, datë 14.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.....	7439
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 10.7.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 16, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	7440
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 10.7.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës automobilistike të fshatit Dumberas, Njësia Administrative Kushovë”, Gramsh.....	7442
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 10.7.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, për sipërfaqet që preken nga ndërtimi i projektit të rrugëve përgjatë bregut jugor të rezervuarit të Moglicës, të pasurive me numër 427, 770, 432/2, 429, 774, 83/5, 769, 90, 88, zona kadastrale 2937, qarku Korçë.....	7443
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 487, datë 10.7.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2019–2020”	7444
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 10.7.2019	Për lirimin nga detyra të drejtorit të Bibliotekës Kombëtare.....	7448
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 490, datë 10.7.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e agjencisë së blerjeve të përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar.....	7448
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 493, datë 11.7.2019	Për përcaktimin si zonë të lirë të një pjese të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në Porto-Romano.....	7448
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 95, datë 17.6.2019	Mbi miratimin e “Udhëzuesit për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik”	7454
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 21.6.2019	Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e periudhës tranzitore të vendosur në pikën 2, të vendimit nr. 46, datë 19.3.2019 të bordit të ERE-s.....	7456
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 98, datë 21.6.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a. për vitin 2019 dhe përditësimin të planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare.....	7459
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 21.6.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	7460

Vendim i Entit Rregullator të
Energjisë nr. 100, datë 21.6.2019

Për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kritereve standarde
dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të
rrjeteve të gazit natyror” 7461

Kërkesë për shpalljen të humbur dhe të vdekur të shtetasit Jani
Janila..... 7473

**VENDIM****Nr. 473, datë 10.7.2019****PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE
DIPLOMATIKE, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMONUELTHIT TË BAHAMAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komonuelthit të Bahamas.

2. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 474, datë 10.7.2019****PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE
NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
KËSHILLIN KOMBËTAR TË
SHQIPTARËVE NË MAL TË ZI, PËR
MBËSHTETJEN E FUNKSIONIMIT TË
KËTIJ KËSHILLI DHE TË ZYRËS
KOORDINUESE TË TIJ NË PLAVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Këshillin Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) euro, për mbështetjen e funksionimit të këtij këshilli dhe të zyrës koordinuese të tij në Plavë.

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin buxhetor “Shpenzime diplomatike jashtë shtetit”, në zërin 605, “Kuota ndërkombëtare”, i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) eurosh, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 475, datë 10.7.2019****PËR DHËNIE KONTRIBUTI
FINANCIAR NGA KËSHILLI I
MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PËR KËSHILLIN
KOMBËTAR SHQIPTAR NË SERBI, PËR
VËNIEN NË FUNKSION TË QENDRËS
KULTURORE (MULTIFUNKSIONALE)
TË KËTIJ KËSHILLI NË KOMUNËN
E BUJANOCIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Dhënien e kontributit financiar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) euro, për vënien në funksion të Qendrës Kulturore (Multifunkionale) të këtij Këshilli në komunën e Bujanocit.

2. Efekti financiar, prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) eurosh, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2019, për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

3. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 477, datë 10.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 607, DATË 27.10.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E MJEDISEVE TË NDËRTESES “GODINA E INOVACIONIT” NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 607, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm t’u jepen në përdorim mjediset në katin e parë (1) të ndërtesës “Godina e inovacionit”, për ushtrimin e veprimtarisë së tyre

Faqe| 7434

administrative, sipas planimetrisë në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.


b) Në pikën 3, fjalët “... deri më 30 qershor 2019 ...” zëvendësohen me “... deri më 31 dhjetor 2019 ...”.

2. Ngarkohen Kryeministria, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
GODINA E INOVACIONIT
KATI I PARË (1)



**VENDIM****Nr. 478, datë 10.7.2019****PËR PROCEDURËN E SIGURISË SË
GJYQATARËVE TË GJYKATAVE KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR, TË PROKURORËVE TË
PROKURORISË SË POSAÇME DHE
DREJTORIT TË BYROSË KOMBËTARE
TË HETIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit u sigurohet mbrojtja personale, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Mbrojtja personale, e parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, ofrohet mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga subjekti që kërkon të mbrohet.

3. Garantimi i mbrojtjes personale të kryetarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit bëhet nëpërmjet shoqërimit me oficer e nënoficer.

4. Garantimi i mbrojtjes personale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme bëhet sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e veçantë të magjistratit.

5. Në raste të veçanta dhe me kërkesë të kryetarit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar apo drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, sigurohet mbrojtje për anëtarët e familjes, banesat dhe/ose eskortë për gjyqtarët dhe prokurorët.

6. Zëvendës drejtorit apo hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, për shkak të apo gjatë ushtrimit të detyrës, u sigurohet mbrojtje personale e jetës, shëndetit dhe pronës, nëse kërkohet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

7. Në rastet e gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme si dhe të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, kërkesa depozitohet pranë komisionit të posaçëm që ngrihet e funksionon sipas procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij.

8. Në rastet e zëvendës drejtorit apo hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, kërkesa vlerësohet nga komisioni i posaçëm, i cili përbëhet nga:

- një përfaqësues i Prokurorisë së Posaçme;
- një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;
- një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme;
- drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit;
- një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

9. Kryetar i komisionit të përcaktuar në pikën 8, të këtij vendimi, është përfaqësuesi i Prokurorisë së Posaçme. Në mungesë të kryetarit, anëtarët thirren nga personi i autorizuar prej tij, i cili kryeson mbledhjen e komisionit.

10. Kërkesa për mbrojtje i paraqitet komisionit atëherë kur ka të dhëna të besueshme, që provojnë se subjektit kërkues apo subjekteve të parashikuara në pikën 6, të këtij vendimi, u rrezikohet jeta, familja ose prona.

11. Procedurat që ndiqen nga komisioni janë të njëjta me procedurat e ndjekura nga komisioni i posaçëm, që garanton mbrojtje të veçantë për magjistratët.

12. Oficerët e caktuar për sigurinë e gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, familjeve dhe banesave të tyre nuk zëvendësohen pa marrë, paraprakisht, miratimin e kryetarit të Gjykatës, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme apo drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

13. Komisionet e posaçme, në varësi të të dhënave dhe gjendjes së rrezikshmërisë, kanë të drejtë të vendosin përf forcimin e masave mbrojtëse për ruajtjen dhe shoqërimin e



subjekteve, të cilave u garantohet mbrojtja, sipas këtij vendimi, si dhe të banesave të tyre.

14. Struktura dhe organika e nevojshme për ruajtjen e shoqërimin e subjekteve, të cilave u garantohet mbrojtja, sipas këtij vendimi, së bashku me ruajtjen e banesave ose të rezidencave të tyre, si dhe kriteret e përzgjedhjes së efektivave që ngarkohen me këtë detyrë, miratohet sipas legjislacionit në fuqi.

15. Ngarkohen kryetarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, Ministria e Brendshme, Garda e Republikës së Shqipërisë dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 479, datë 10.7.2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR PROCEDURAT NË
LIDHJE ME GARANTIMIN E SIGURISË
NË MJEDISËT E GJYKATAVE KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR, TË PROKURORISË SË
POSAÇME DHE TË BYROSË
KOMBËTARE TË HETIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 46, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave të hollësishme për procedurat në lidhje me garantimin e sigurisë në mjediset e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

I. OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për procedurat në lidhje me garantimin e sigurisë së mjedisëve të gjykatave

kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Këto rregulla nuk duhet të cenojnë veprimtarinë gjyqësore dhe administrative të institucioneve si dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore, në mënyrë publike e transparente.

II. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “Personeli i sigurisë”, punonjësit e ngarkuar për të garantuar rendin dhe sigurinë në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë pjesë e shërbimit të vijueshëm të Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

2. “Institucion”, gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr.95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

3. “Ambiente”, ambientet e brendshme të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe trualli funksional përreth, duke përfshirë edhe parkingun për automjetet.

4. “Kryetar”, kryetari i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

5. “Siguria e godinës”, ndalimi i hyrjes së paligjshme, dëmtimi dhe kryerja e akteve të dhunshme ndaj ambienteve, sjellja e eksplozivëve, e armëve ose sendeve të tjera që mund të përdoren si armë, ose çdo aktiviteti tjetër të paligjshëm ndaj ambienteve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

6. “Sistemi i sigurisë”, sistemi ku ndodhen këto institucione, që përbëhet nga perimetri rrethues i godinës, deri ku shtrihet më tej ai i vëzhgimit apo kontrollit të autorizuar në rast nevojë të parandalimit të rrezikut, ai i sinjalizimit të hyrjeve të parregullta, metal-dedektorët, sistemi i kamera-vëzhgimit, ai elektronik i lejimit e kufizimit të aksesit në hyrjet e institucioneve, ruajtja e të dhënave të tyre, punonjësit e sigurisë.



III. RREGULLAT E SIGURISË

1. Hyrja në godinë:

a) hyrjet kryesore të godinës mbikëqyren nga një ose disa punonjës të sigurisë;

b) kryetari i institucionit përkatës autorizon personelin, si dhe persona të tjerë, të hyjnë në ambientet e tyre, nëpërmjet një hyrjeje të veçantë;

c) hyrja e veçantë, e parashikuar në shkronjën “b”, shërben edhe si dalje emergjence në rastet kur jepet urdhër për evakuim nga kryetari i institucionit përkatës.

2. Hyrja e automjeteve:

a) Hyrja e automjeteve në ambientet e institucioneve të përcaktuara sipas këtij vendimi realizohet përmes portave të veçanta për hyrjen e automjeteve.

b) Hyrja e automjeteve mbikëqyret me punonjës sigurie.

3. Siguria në godinën e institucionit:

a) Kryetari i institucionit përkatës, në bashkëpunim me titullarin e strukturës së policisë, përcakton rregulla të hollësishme lidhur me vendosjen e pajisjeve të nevojshme të sigurisë në hyrjen kryesore dhe në brendësi të godinës së institucionit përkatës, në varësi të shkallës së rrezikshmërisë të vlerësuar në vijimësi.

4. Rregullat bazë të sigurisë që duhet të përmbushen janë, si më poshtë vijon:

a) pajisja me detektorë elektronikë, të cilët vendosen pranë hyrjes kryesore;

b) vendosja e pajisjeve për fikjen e zjarrit;

c) sinjalizimi i daljes së emergjencës;

ç) harta e ambienteve të godinës së institucionit përkatës;

d) pajisja me mjete të sigurisë (çelësa, karta apo mjete të tjera të kësaj natyre) e punonjësve të administratës së institucionit përkatës, me qëllim realizimin e hyrjes nëpërmjet hyrjes së veçantë të godinës së institucionit përkatës;

dh) pajisja me sistemin e kamerave të vëzhgimit dhe atë elektronik të lejimit të hyrjes në godinë, si dhe në server të ruajtjes së këtyre të dhënave për një periudhë 6-mujore deri në 1 vit.

5. Informacioni i përmbledhur për rregullat bazë të sigurisë shpallet në një vend të dukshëm në ambientet hyrëse të institucionit përkatës.

IV. PERSONELI I SIGURISË

1. Personeli i sigurisë garanton rendin dhe sigurinë në:

a) hyrjet publike të institucionit përkatës;

b) portat për hyrjen e automjeteve dhe hapësirën e parkimit;

c) sallën e gjyqit, nëse i kërkohet nga kryetari i trupit gjykues. Në rastin kur ka të pandehur/të arrestuar është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ajo që bën shoqërimin dhe sigurimin e tyre;

ç) ambientet e tjera të brendshme të godinës së institucionit përkatës, të cilat përfshijnë kryesisht korridoret lidhëse pranë zyrave.

2. Personeli i sigurisë mund të kontrollojë hyrjen e godinës apo të kontrollojë automjetet dhe personat që dyshohen se përbëjnë rrezik për sigurinë e mjediseve, brenda një perimetri prej 5 metrash rreth godinës së gjykatës, duke nisur prej vijës së objektit.

3. Procedurat e verifikimit dhe të kontrollit të personave nga personeli i sigurisë janë, si më poshtë vijon:

a) lejohet të verifikojnë identitetin e personave që hyjnë, qëndrojnë ose largohen nga ambientet e institucionit, nëpërmjet ekzaminimit të dokumenteve të identitetit të atij personi;

b) në rast se personi që hyn nuk posedon dokument identifikimi, identifikimi i tyre mund të konfirmohet në një mënyrë tjetër të përshtatshme;

c) në rast se identiteti i personit nuk mund të konfirmohet, personeli i sigurimit nuk lejon hyrjen në institucion;

ç) kryen kontrollin fizik të personave që hyjnë, qëndrojnë ose largohen nga ambientet e institucionit, si dhe të sendeve që zotërojnë apo mbajnë me vete;

d) ndarja në mes të atyre që përdorin hyrjen kryesore dhe atyre që përdorin hyrje tjetër do të bëhet në përputhje me rregullat e ligjit për protokollin e shtetit, për personat dhe personalitete që hyjnë në institucion pa kontroll fizik;

dh) kontrolli sipas shkronjës “ç” mund të bëhet me këqyrje, përmes prekjës sipërfaqësore ose duke përdorur mjete të tjera të përshtatshme, të tilla si pasqyra ose detektorë;

e) kontrolli që përfshin prekjën sipërfaqësore bëhet nga personeli i sigurisë me gjininë e njëjtë me personin që hyn, qëndron ose largohet nga ambientet e institucionit, përveçse nëse në raste të jashtëzakonshme kjo nuk është e mundur;

ë) pajis personin që kërkon të hyjë në ambientet e institucionit përkatës me leje hyrjeje dhe regjistron këto të dhëna në regjistrë:

- emrin dhe mbiemrin e personit;



- punonjës/in/zyrtarin pritës;
- orarin e hyrjes dhe të daljes nga institucioni;

f) në rast se personi nuk largohet brenda orarit zyrtar, punonjësi i sigurisë njofton kancelarin dhe, në mungesë të tij, kryetarin.

4. Regjistrimi i sendeve:

a) personeli i sigurisë, me pëlqimin e personit që kontrollohet, mund të mbajë përkohësisht sende të personit, me qëllim për të lejuar personin të hyjë në ambientet e institucionit;

b) regjistrimi i sendeve të mbajtura bëhet në formë të shkruar dhe me nënshkrimin e personit që posedon këtë send.

5. Rastet e moslejimit të mbajtjes së sendeve dhe të kafshëve:

a) përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në legjislacionin në fuqi, në ambientet e institucionit nuk lejohet mbajtja e sendeve, si:

- armë zjarri;
- eksplozivë;
- thika të çfarëdolloj gjatësie;
- sende të mprehta ose me majë (duke përfshirë: brisqe, gërshtë, kaçavida ose çdo send tjetër të ngjashëm);

- spray për mbrojtje;

- pranga;
- lëndë dhe substanca narkotike;

b) mbajtja e kafshëve;

c) çdo mjet tjetër që mund të përbëjë rrezik për sigurinë dhe rendin në institucion;

ç) në rastin kur mbajtja e sendeve të ndaluara përbën vepër penale, personeli i sigurisë autorizohet të ndalojë mbajtësin e tyre dhe të njoftojë menjëherë policinë gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Rregullat e sendeve të ndaluara nuk zbatohen në rastet e personave, të cilëve me ligj iu lejohet mbajtja e armëve të zjarrit, ose sendet përbëjnë provë materiale dhe paraqiten si të tilla në gjykatë.

6. Detyrat e personelit të sigurisë janë, si më poshtë vijon:

a) të sigurojnë ndalimin e hyrjes për personat, të cilët paraqesin rrezik për sigurinë e personave ose godinës në institucionin përkatës;

b) të ushtrojnë kontroll personal nëpërmjet pajisjeve teknike dhe të inspektojnë çantat e personave që hyjnë në ambientet e brendshme të institucionit;

c) të marrin masa për bllokimin e sendeve, mbajtja dhe futja në institucion e të cilave është e ndaluar sipas këtij vendimi;

ç) të informojnë kryetarin për sjellje të dyshimta nga personat që gjenden në godinën e institucionit përkatës;

d) të marrin masa për kufizimin e qarkullimit të automjeteve të palejuara në hapësirat e parkimit, në garazhe, si dhe në oborrin e institucionit përkatës;

dh) të përdorin forcën fizike në përputhje dhe proporcion me rastet që e kanë diktuar atë dhe aq sa është e nevojshme për të shmangur apo neutralizuar situatën e rrezikut të krijuar;

e) të raportojnë pranë kryetarit telefonatat që përmbajnë kërcënime të shprehura apo nënkuptojnë mundësinë e një rreziku për gjyqtarët apo punonjësit e institucioneve përkatëse;

ë) të japin udhëzime të shprehura në zbatim të urdhrave të kryetarit;

f) të mbajnë kontakte të vazhdueshme me institucione, si policia, spitalet, zjarrfikëset dhe ia raportojnë periodikisht kryetarit;

g) të ndërmarrin kontrole rutinë për pajisjet e sigurisë dhe t'i raportojnë kryetarit në rast të mosfunksionimit të këtyre pajisjeve;

gj) të kryejnë evakuimin e godinës, në zbatim të urdhrit verbal të kryetarit. Në rastet e rrezikut të madh e të menjëhershëm, evakuimi mund të kryhet edhe pa urdhër të kryetarit;

h) të informojnë menjëherë kryetarin, si dhe Policinë e Shtetit, për çdo ngjarje të rëndë që cenon sigurinë në institucionet përkatëse, e cila konstatohet pas orarit zyrtar.

V. DREJTIMI I PERSONELIT TË SIGURISË

1. Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë së shërbimeve të sigurisë nga Policia e Shtetit realizohen nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit të institucionit përkatës dhe të titullarit të strukturës policore.

2. Kompetencat e kryetarit të institucionit përkatës janë, si më poshtë vijon:

a) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e personelit të sigurisë në institucionin përkatës;

b) jep urdhra verbalë për evakuim, si më poshtë vijon:

- në rast rreziku brenda godinës, që nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër;

- në rast aktivizimi të sistemit të alarmit për rënien e zjarrit.



c) merr kontakte të herëpashershme me strukturat drejtuese të Policisë së Shtetit, për të siguruar rendin dhe sigurinë në ambientet e institucionit;

ç) merr çdo masë tjetër të nevojshme për të garantuar rendin dhe sigurinë në ambientet e institucionit.

3. Kryetari i institucionit përkatës, në bashkëpunim me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, miraton një rregullore të brendshme në të cilën përcaktohen detyrimet e masave të sigurisë dhe të veprimeve për të gjitha ambientet e institucionit.

4. Titullari i strukturës policore, që do të ngarkohet me sigurimin e këtij institucioni, ka për detyrë të përgatisë planin e vendosjes së shërbimit, duke marrë në konsideratë organikën e institucionit, detyrime që rrjedhin nga ky vendim dhe nga rregullorja e brendshme.

VI. INSTITUCIONET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe kryetarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe drejtori i Byrosë së Hetimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 480, datë 10.7.2019

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË TATIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2009, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zoti Enton Duro, drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve, shkarkohet nga kjo detyrë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 482, datë 10.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 419, DATË 14.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E AFATEVE DHE TË SKEMËS SË SHPËRNDARJES SË FONDEVE TË DËMSPËRBLIMIT PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 419, datë 14.4.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Në pikën 4, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

“Për të gjitha subjektet përfituese parësore, kur vlera totale e dëmshpërblimit është mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë vijohet me pagesën e kështit pasardhës deri në shpërndarjen e plotë të shumës së miratuar. Në rast se vlera totale e miratuar për të gjithë përfituesit është deri në 1 000 000 (një milion) lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit kryhet



me një këst të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.”.

4. Paragrafi i fundit, i pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit për të gjithë përfituesit, brenda kështit më të ulët fillon pagesa e kështit pasardhës. Ky mekanizëm përsëritet deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.”.

5. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Financave”, “Ministri i Financave”, “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët “ministria përgjegjëse për financat”, “ministri përgjegjës për financat”, “ministria përgjegjëse për çështjet sociale”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 483, datë 10.7.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 16, DATË 16.1.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOQSHME PËR VITIN 2019 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.16, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 1 806 punonjës.

b) në lidhjen nr.1, të përmendur në pikën 1, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

i. ndarja “Gr. 30, Gjykata Kushtetuese” shtohet sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ii. në ndarjet “Gr. 02, Kuvendi”; “Gr. 05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”; “Gr. 06, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”; “Gr. 10, Ministria e Financave dhe Ekonomisë”; “Gr. 14, Ministria e Drejtësisë”; “Gr. 26, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”; “Gr. 29, Këshilli i Lartë Gjyqësor”; “Gr. 87, Institucione të tjera qeveritare” dhe “Gr.95, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, shtohen nënndarjet përkatëse sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lidhja nr.1

Gr.	Emri i Institucionit		Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
2	Kuvendi	3			
	Kuvendi	2	Inventarizues	8 orë/ditë	6 Muaj
	Kuvendi	1	Punëtor mirmbajtje	8 orë/ditë	6 Muaj
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	6			
	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	2	Laborant	8 orë/ditë	6 Muaj
	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	2	Teknik i mesëm	8 orë/ditë	6 Muaj
	AZHBR (Agropikat)	2	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2			
	Aparati	1	Specialist në Sekretariatën e Naftës	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati	1	Operator EDRMS	8 orë/ditë	6 Muaj
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	18			
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike)	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Apelit të Tatimor)	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Sektori i Arkiv-Protokollit)	2	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Sektori i Arkiv-Protokollit)	2	Operator EDRMS	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator)	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Sektori i Burimeve Njerëzore)	2	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme)	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Sektori i Prokurimeve)	2	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar)	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Sektori i Integritetit dhe Koordinimit)	2	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Aparati i Ministrisë (Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik)	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit (Dega Fier)	1	Punonjës arkive	8 orë/ditë	6 Muaj
14	Ministria e Drejtësisë	7			
	Aparati i Ministrisë	5	Operator	8 orë/ditë	6 Muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	1	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Zyra Vendore e Përmbarimit Gjyqësor Tiranë	1	Ftues	8 orë/ditë	6 Muaj
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	9			
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	8	Operator	8 orë/ditë	4 Muaj
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	1	Punëtor mirmbajtje	6 orë/ditë	6 Muaj
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	3			
	Kolegji Zgjedhor	3	Sekretare gjyqësore	8 orë/ditë	6 Muaj
30	Gjykata Kushtetuese	4			
	Gjykata Kushtetuese	4	Punonjës arkive	8 orë/ditë	6 Muaj
87	Agjencia Kombëtare e Diasporës	1			
	Agjencia Kombëtare e Diasporës	1	Operator	8 orë/ditë	6 Muaj
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish sigurimit	5			
	Aparati	5	Punonjës arkive	8 orë/ditë	6 Muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	58			
1,806					



VENDIM
Nr. 485, datë 10.7.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I
RRUGËS AUTOMOBILISTIKE TË
FSHATIT DUMBERAS, NJËSIA
ADMINISTRATIVE KUSHOVË”,
GRAMSH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës automobilistike të fshatit Dumberas, Njësia Administrative Kushovë”, Gramsh.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Gramsh.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “tokë bujqësore”, me një vlerë të përgjithshme prej 156 600 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 156 600 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e

gjashtëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Gramsh.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Gramsh.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Gramsh, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Gramsh.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Gramsh, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Gramsh, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Zyra Vendore Gramsh, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**Lista e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga realizimi i projektit:
“Rikonstruksion i rrugës automobilistike në fshatin Dumberas, Njësia Administrative
Kushovë”, Bashkia Gramsh**

Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër, Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr./pasurisë	Sipërfaqja e prekur		Çmimi Tokë bujqësore / m ²	Vlera e Tokës bujqësore / Lekë	Vlera totale / Lekë	Shënime Konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
				Tokë bujqësore / m ²	Ndërtesë / m ²				
1	Misir Sako Zani	2347	5/11	900		174	156, 600	156, 600	Konfirmuar nga ZVRPP
Vlera totale e shpronësimit								156,600	

VENDIM

Nr. 486, datë 10.7.2019

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT, NGA KATEGORIA E
RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË
“TOKË URBANE” TRUALL, PËR
SIPËRFAQET QË PREKEN NGA
NDËRTIMI I PROJEKTIT TË RRUGËVE
PËRGJATË BREGUT JUGOR TË
REZERVUARIT TË MOGLICËS, TË
PASURIVE ME NUMËR 427, 770, 432/2,
429, 774, 83/5, 769, 90, 88, ZONA
KADASTRALE 2937, QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe të vendimit nr. 410, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të tokës, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për parcelat me sipërfaqe të

përgjithshme 1 845 (një mijë e tetëqind e dyzet e pesë) m², pjesë e pasurive numër 427, 770, 432/2, 429, 774, 83/5, 769, 90, 88, zona kadastrale 2937, me vendndodhje në njësinë administrative Moglicë, Bashkia Maliq, qarku Korçë, të cilat preken nga “Projekti hidroenergjetik i Devollit, për ndërtimin e rrugëve përgjatë bregut jugor të rezervuarit të Moglicës”, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës në Qarkun e Korçës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, respektivisht për secilën parcelë, për aq sa preket nga ndërtimi i rrugëve përgjatë bregut jugor të rezervuarit të Moglicës, parcelat me numër pasurie 427, 770, 432/2, 429, 774, 83/5, 769, 90, 88, zona kadastrale 2937, me vendndodhje në njësinë administrative Moglicë, Bashkia Maliq, qarku Korçë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës në Qarkun e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



Lidhja 1

Nr.	VEPRA	QARKU	ZONA KADAST	FSHATI	STATUSI PRONËS	PARCELA Nr.	PËRDORIMI	SIPërFAQE NË KARTELË (m²)	SIPërFAQJA QË NDRYSHON STATUSIN (m²)
1	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	427	TOKË BUJQËSORE	869	435
2	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	770	TOKË BUJQËSORE	2,247	265
3	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	432/2	TOKË BUJQËSORE	648	5
4	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	429	TOKE BUJQËSORE	210	8
5	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	774	TOKË BUJQËSORE	1585	11
6	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	83/5	TOKË BUJQËSORE	554	5
7	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	769	TOKË BUJQËSORE	2535	652
8	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	90	TOKE BUJQËSORE	461	282
9	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHITET	88	TOKË BUJQËSORE	612	182
							TOTALI (m²)	1,845.00	

VENDIM

Nr. 487, datë 10.7.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 295, DATË 10.5.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E KRITERIT TË NOTËS MESATARE
PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË
PROGRAMET E STUDIMEVE TË
CIKLIT TË PARË DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE
TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË
VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE
PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN
AKADEMIK 2019–2020”**

shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shtojca 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 74, pika 1, e 76, pika 2, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin



SHTOJCA 1

Nr.	INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1	Universiteti i Tiranës	Biologji	7.5
2		Filozofi	7.5
3		Fizikë	7.5
4		Gjeografi	7.5
5		Gjuhë angleze	7.5
6		Gjuhë angleze (Sarandë)	7.5
7		Gjuhë frënge	7.5
8		Gjuhë gjermane	7.5
9		Gjuhë greke	7.5
10		Gjuhë italiane	7.5
11		Gjuhë - Letërsi	7.5
12		Gjuhë ruse	7.5
13		Gjuhë spanjolle me profil gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik	7.5
14		Gjuhë turke	7.5
15		Histori	7.5
16		Informatikë	7.5
17		Kimi	7.5
18		Matematikë	7.5
19		Psikologji	7.5
20		Sociologji	7.5
Nr.	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Edukim qytetar	7.5
3		Filozofi - Sociologji	7.5
4		Gjeografi dhe gjuhë italiane	7.5
5		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5
6		Gjuhë angleze	7.5
7		Gjuhë frënge	7.5
8		Gjuhë gjermane	7.5
9		Gjuhë italiane	7.5
10		Histori - Gjeografi	7.5
11		Histori dhe gjuhë gjermane	7.5
12		Matematikë informatike	7.5
13		Matematikë - Fizikë	7.5
14		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
15		Mësuesi për arsim fillor	7.5
16		Psikologji	7.5
Nr.	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Gjuhë gjermane dhe angleze	7.5
2		Gjuhë Angleze	7.5
3		Gjuhë - Letërsi - Anglisht	7.5



4		Histori	7.5
5		Informatikë - Anglisht	7.5
6		Matematikë - Informatikë	7.5
7		Mësuesi për arsim fillor	7.5
8		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
9		Psikologji	7.5
10		Filozofi - Sociologji	7.5
Nr.	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Gjuhë - Letërsi shqipe	7.5
3		Gjuhë - Letërsi angleze	7.5
4		Gjuhë - Letërsi dhe Qytetërim grek	7.5
5		Gjuhë - Letërsi italiane	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Matematikë - Informatikë	7.5
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
10		Fizikë dhe teknologji informacioni	7.5
11		Matematikë-Fizikë	7.5
Nr.	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Filozofi - Sociologji	7.5
3		Gjuhë angleze	7.5
4		Gjuhë dhe kulturë frënge	7.5
5		Gjuhë - Letërsi	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Matematikë - Fizikë	7.5
8		Matematikë - Informatikë	7.5
9		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
10		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
Nr.	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	PROGRAMI I STUDIMIT	
1		Biologji	7.5
2		Fizikë	7.5
3		Gjuhë angleze	7.5
4		Gjuhë italiane	7.5
5		Gjuhë shqipe dhe Letërsi	7.5
6		Histori - Gjeografi	7.5
7		Informatikë	7.5
8		Kimi	7.5
9		Matematikë	7.5
10		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
11		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
12		Pedagogji e specializuar	7.5



Nr.	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Biologji - Kimi	7.5
2		Fizikë	7.5
3		Gjeografi	7.5
4		Gjuhë - Letërsi	7.5
5		Gjuhë angleze	7.5
6		Gjuhë frënge	7.5
7		Gjuhë gjermane	7.5
8		Gjuhë italiane	7.5
9		Histori	7.5
10		Informatikë	7.5
11		Matematikë	7.5
12		Mësuesi për Arsim Fillor	7.5
13		Mësuesi për Arsim parashkollor	7.5
14		Psikologji	7.5
Nr.	Kolegji universitar “Bedër”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Arsimi parashkollor dhe fillor	7.5
2		Gjuhë dhe letërsi angleze	7.5
3		Psikologji këshillimi dhe Pedagogji	7.5
Nr.	Kolegji universitar “Wisdom”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
Nr.	SHLUJ, Universiteti “Marin Barleti”	PROGRAMI I STUDIMIT	7.5
1		Psikologji	
Nr.	Universiteti Europian i Tiranës	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
2		Sociologji	7.5
3		Filozofi	7.5
4		Histori	7.5
5		Letërsi	7.5
6		Linguistikë	7.5
7		Arsim parashkollor	7.5
Nr.	Universiteti i New York-ut në Tiranë	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Psikologji	7.5
Nr.	Universiteti privat “Albanian University”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Anglisht	7.5
2		Mësuesi për arsimin fillor	7.5
3		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
4		Psikologji e përgjithshme	7.5
Nr.	Kolegji universitar “Logos”	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE
1		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
2		Gjuhë dhe Civilizim grek	7.5

**VENDIM****Nr. 489, datë 10.7.2019****PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
DREJTORIT TË BIBLIOTEKËS
KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11, të nenit 27, të ligjit nr. 8576, datë 3.2.2000, “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Persida Asllani, drejtor i Bibliotekës Kombëtare, të lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 490, datë 10.7.2019****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 82, DATË 14.2.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E
AGJENCISË SË BLERJEVE TË
PËRQENDRUARA PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI
TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE
DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË,
PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 2, të tekstit “Rregullat e prokurimit publik”, bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Përjashtohen nga zbatimi i këtij vendimi përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, për nevojat e tyre, si dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera shtetërore të atashuar pranë tyre. Për këto kategori, procedurat për blerje automjetesh realizohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë të akredituara jashtë vendit, sipas rregullave të tyre të brendshme.”.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 493, datë 11.7.2019****PËR PËRCAKTIMIN SI ZONË TË LIRË
TË NJË PJESE TË TERRITORIT
DOGANOR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PORTO-ROMANO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 216, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:


1. Përcaktimin si zonë të lirë të një pjese të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në Porto-Romano.


2. Planvendosja e zonës së lirë dhe pikat e hyrjes e të daljes përcaktohen në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ushtrimi i veprimtarisë në zonën e lirë do të autorizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pas plotësimit nga aplikuesi të kushteve dhe të kriterëve të parashikuara në kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për këtë qëllim.

4. Të gjitha shpenzimet për rrethimin e zonës së lirë, plotësimin e kushteve të punës dhe për sistemet e monitorimit me videokamera e të ndriçimit, për ushtrimin e mbikëqyrjes nga autoritetet doganore, të përcaktuara në legjislacion, do të kryhen nga aplikuesi.









VENDIM

Nr. 95, datë 17.6.2019

**MBI MIRATIMIN E “UDHËZUESIT PËR
TESTIMIN E TREGUT PËR
GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK”**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1, germa “a”; 16, pika 24 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të rregullatorëve të energjisë mbi aplikimin e përjashtimit të TAP AG, datë 6 qershor 2013, lëshuar nga autoritetet sipas direktivës 2009/73/EC (“Opinionit Përfundimtar i Përbashkët”), i Kodit të Tarifave të TAP AG dhe të rregullores së BE-së 2017/459 për krijimin e një Kodi të Rrjetit mbi Mekanizmat për Alokimin e Kapacitetit për sistemet e transmetimit të gazit (“Mekanizmi për alokimin e kapacitetit për Kodin e Rrjetit”), si dhe neneve 15 dhe 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 17.6.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përparësuar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi miratimin e “Udhëzuesit për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik”, dokumenti i paraqitur i propozuar nga TAP AG,

konstatoi se:

Duke pasur parasysh që¹:

Në datën 29 gusht 2011 TAP AG paraqiti në Ministrinë italiane të Zhvillimit Ekonomik dhe në datën 31 gusht 2011 paraqiti tek Autoriteti Rregullator i Energjisë në Greqi (RAE) “Aplikimin e përjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik”, si parashikohet nga neni 36 i direktivës së gazit 2009/73/EC. Në datën 1 shtator 2011 TAP AG paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë (ERE) “Aplikimin e përjashtimit të Gazsjellësit Trans Adriatik”, sipas nenit 22 të direktivës së gazit 2003/55/EC.

Në qershor 2013, Ministria e Italisë, RAE dhe ERE morën vendimin për përjashtimin duke

miratuar “Opinionin Përfundimtar të Përbashkët”, një dokument i shkruar në mënyrë të përbashkët nga ARERA, ERE dhe RAE (këtu dhe më poshtë: “Autoritetet”) dhe e ndryshuan për t’u përputhur me vendimin e komisionit [C(2013)2949 përfundimtar] datë 16 maj 2013 dhe morën parasysh Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013.

Tek dokumenti i përmendur përjashtimi nga dispozitat e nenit 9 (Veçimi) 32 (TPA), për kapacitet fillestar prej 10 miliardë metër kub në vit dhe 41.6, 41.8, 41.10 (tarifat e rregulluara) të direktivës së gazit i janë dhënë TAP AG për një periudhë 25-vjeçare duke filluar nga data e vendosjes në punë (DVP), sipas kushteve të ndryshme. Midis të tjerave, sipas nenit 4.1.7, TAP AG është e detyruar të kryejë testimin e tregut rregullisht duke filluar jo më vonë se data e vendosjes në punë dhe si pasojë të paktën çdo dy vjet. TAP AG duhet të kryejë testimin e tregut, sipas udhëzimeve që do të miratohen nga autoritetet për t’u ofruar të gjitha palëve të interesuara kapacitet shtesë mbi kapacitetin total prej 20 miliardë metër kub/vit².

Sipas nenit 4.1.7 TAP AG është e detyruar të përmbushë kërkesat detyruese të kapacitetit të cilat vijnë si rezultat i çdo testimi tregu duke pasur parasysh dispozitat e pikave 2,6 dhe 9 të §4.7 të “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët”. Zgjerimi kryhet nëse është i realizueshëm nga ana ekonomike, që do të thotë nëse të ardhurat shtesë nga kapaciteti si rrjedhojë e çdo testimi të tregut janë të barabarta ose më të mëdha se kostot shtesë efektive, të përcaktuara sipas metodologjisë së TAP-it, siç përcaktohet në Kodin Tarifor të TAP-it.

U vendosen terma të tjera për të ruajtur përputhjen e plotë të kriterit të nenit 36.1, ku midis të tjerave:

1. Detyrimi për të paraqitur për miratim Kodin e Rrjetit, jo më vonë se 12 muaj para datës së vendosjes në punë (DVP). Kodi i Rrjetit duhet të pajtohet me të gjitha dispozitat e rregullores

² Sipas nenit 4.1.9, mundësia për të zgjeruar më tej kapacitetin mbi kapacitetin total, (që do të thotë mbi 20 miliardë metër kub në vit), do të shqyrtohet nga TAP AG dhe nëse është ekonomikisht dhe teknikisht e realizueshme, ajo do të ndërmerret, për të përmbushur të gjitha kërkesat për kapacitet afatgjatë (afatgjatë nënkupton një kohëzgjatje prej më shumë se 15 vjet).

¹ Këtu dhe më poshtë aplikohen përcaktimet e “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët” dhe të rregullores së BE 2017/459.



715/2009 dhe kodeve europianë të rrjetit, neni 8.6 i rregullores 715/2009 që nuk bie ndesh me kushtet e “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët”;

2. Detyrimin për të ndërtuar pika të tjera hyrje dhe dalje në Greqi dhe Shqipëri sipas kërkesës së palës së tretë, si pasojë e testimit të tregut, për sa kohë ky ndërtim është teknikisht i realizueshëm. Prova kryesore për të demonstruar që ndërtimi i këtyre pikave shtesë të hyrjes/daljes nuk është teknikisht i realizueshëm mbështetur te TAP AG. Nëse kjo kërket nga autoritetet, TAP AG do të sigurojë një opinion nga një palë e tretë e pavarur. Të gjitha kostot në lidhje me ndërtimin dhe funksionimin e këtyre pikave të hyrjes dhe daljes do t'i kalojnë palës së tretë e cila bëri kërkesën, sipas legjislacionit të vendit në kohën e kërkesës. Kostot që kanë lidhje me këto pika hyrje dhe dalje nuk do të përfshijnë investimet që kërkojnë për kapacitetin shtesë të TAP, sipas §4.1 të “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët”, i cili do të paguhet sipas tarifave të TAP-it;

Në datën 16 mars 2017, u miratua rregullorja e re e BE-së 459/2017 “Për krijimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapacitetit të sistemit të transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e rregullores së BE-së nr. 984/2013”. Rregullorja e BE-së 2017/459 (këtu dhe më poshtë “Rregullorja”) krijon një Kod të Rrjetit ku përcaktohen mekanizmat për alokimin e kapacitetit në sistemit të transmetimit të gazit për kapacitetin ekzistues dhe kapacitetin në rritje.

TAP AG tashmë duhet të fillojë testimin e parë të tregut për zgjerimin (rritjen) e kapacitetit jo më vonë se data e vendosjes në punë (DVP), e cila parashikohet të jetë gjatë vitit 2020.

TAP AG u ka paraqitur autoriteteve udhëzimet për testimin e tregut, duke synuar harmonizimin me dispozitat përkatëse të “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët” me rregulloren e BE-së 2017/459, veçanërisht duke koordinuar periudhat kohore/afatet e pritshme dhe duke forcuar bashkëpunimin me OST-të fqinje.

Pikat kryesore të udhëzimeve të propozuara janë:

1. Procesi ndahet në dy faza, një fazë jodetyruese (ku përfshihet vlerësimi i kërkesës dhe parashikimi i zgjerimit) dhe faza detyruese (ku përfshihet periudha e informimit dhe faza e ofertimit detyrues);

2. Fazat e përmendura më sipër duhet të ndjekin kalendarin e ENTSG-ut, siç përcaktohet te Mekanizmi i Alokimit të Kapacitetit për Kodin e Rrjetit (MAK KRr).

3. Procesi përsëritet të paktën çdo vit tek menjëherë pas fillimit të Ankandit Vjetor të Kapacitetit (në rastin e vitit 2019, faza jodetyruese fillon më 1 korrik);

4. Procedura është e hapur për të gjitha palët e interesuara, që do të thotë çdo person juridik që është i interesuar për të paraqitur treguesit detyrues dhe jodetyrues të kërkesës për kapacitet të TAP dhe të marrë pjesë te testimi i tregut i TAP-it në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese;

5. Gjatë testimit të tregut, të gjitha palët e interesuara mund të kërkojnë zgjerimin e kapacitetit në hyrje dhe/ose në dalje të sistemit të transportit të TAP-it, si dhe ndërtimin e pikave të reja të hyrjes dhe/ose daljes përgjatë sistemit të transportit të TAP-it;

6. Palët e interesuara duhet t'i paraqesin autoriteteve deklaratën për të siguruar që treguesit e tyre jo detyrues të kërkesës pajtohet me limitet e kapacitetit që aplikohen; po ashtu duhet t'i konfirmojnë TAP AG, të paktën dy javë para përfundimit të fazës së vlerësimit që autoritetet e kanë marrë në konsideratë kërkesën në përputhje me limitet e kapaciteteve.

7. Palët e interesuara të cilat paraqesin treguesit jodetyrues të kërkesës për TAP janë të detyruara t'i paraqesin treguesit jodetyrues të kërkesës OST-ve fqinje sipas rregullave të Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit (MAK KRr), ose duhet të sigurojnë kapacitetin e interkonjeksionit sipas procedurave përkatëse në vendet që nuk janë pjesë të BE-së;

8. Raporti për Vlerësimin e Kërkesës (DAR) hartohet dhe publikohet së bashku me OST-të fqinje të BE-së dhe do të përfshijë kërkesat në të ardhmen për zgjerimin në pikat e interkonjeksionit. Raportet do të ndërtohen sipas një modeli të hartuar nga ENTSG dhe do të pasqyrojnë nenet 26/ (12) dhe 26 (13) të Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit (MAK KRr);

9. Faza detyruese projektohet tek udhëzimet që propozohen, sepse rregullat e detajuara varen nga kërkesat e marra gjatë fazës jodetyruese dhe do t'i nënshtrohen miratimit të Autoriteteve;

10. Për të siguruar një pjesëmarrje domethënëse në fazën jodetyruese të testimit të tregut,



parashikohet një tarifë e cila duhet të parapaguhet për të mbuluar kostot e administrimit të procedurës; një tarifë tjetër parashikohet për studimet teknike për kërkesat për lidhje gjatë fazës së projektimit të zgjerimit; shuma duhet të paguhet para fillimit të fazës së projektimit. Tarifa Administrative i rimburohet palëve përkatëse të interesuara sipas një testi të suksesshëm të realizueshmërisë ekonomike dhe ekzekutimin e të paktën një marrëveshjeje të Transportit të Gazit për Kapacitetin e Sigurt Afatgjatë me çdo përdorues, po ashtu në rastin kur ajo është e ndryshme nga pala e interesuar që ka bërë kërkesën.

Duke pasur parasysh:

- Udhëzimi i propozuar përmbledhur më sipër, lidhet me parimet e përmendura tek “Opiniononi Përfundimtar i Përbashkët”, të Mekanizmi i Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit dhe të legjislacionet në vend dhe nuk paraqesin pengesa të panevojshme për procesin që parashikohet për ndërtimin e kapacitetit në rritje;

- Procesi është hartuar në mënyrë të tillë që të lehtësojë bashkëpunimin me OST-në fqinje, në mënyrë që të sigurojë zhvillimin e koordinuar të rrjetit, duke shmangur mospërputhjet e mundshme në ndërtimin e kapacitetit ndërkufitar;

- Nevojitet që të përcaktohet procedura për të konfirmuar pajtueshmërinë me limitet e kapacitetit;

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Udhëzuesin për testimin e tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik” dokumenti i paraqitur i propozuar nga TAP AG.

2. Në rast mospajtueshmërie të kërkesave të kapacitetit me limitet e kapacitetit, autoritetet do të njoftojnë me shkrim palën e interesuar. Në mungesë të këtij njoftimi, kërkesa konsiderohet e përmbushur.

3. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët për versionit shqip.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Adriatik Bego

VENDIM Nr. 97, datë 21.6.2019

MBI KËRKESËN E OSHEE SHA PËR SHTYRJEN E PERIUDHËS TRANZITORE TË VENDOSUR NË PIKËN 2 TË VENDIMIT NR. 46, DATË 19.3.2019 TË BORDIT TË ERE-S

Në mbështetje të nenit 10 pika 2, nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 180 i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me kërkesën e OSHEE sh.a., për shtyrjen e periudhës tranzitore të vendosur me pikën 2 të vendimit nr. 46, datë 19.3.2019 të bordit të ERE, deri në fund të vitit 2019, si dhe shqyrtoi çështjet e parashtruara nga përfaqësuesit e OSHEE sh.a. për shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, si dhe argumentet e parashtruara nga përfaqësuesi i shoqërisë GEN-i Tirana sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 13493 prot., datë 19.6.2019, paraqiti në ERE një kërkesë për zgjatjen e periudhës tranzitore të vendosur me pikën 2, të vendimit nr. 46, datë 19.3.2019, të bordit të ERE-s, deri në fund të vitit 2019.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 46, datë 19.3.2019 është shprehur duke vendosur:

1. Pëzullimin e zbatimit të nenit 20, germa “a” të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103 datë 23.6.2016, për sigurimin e energjisë elektrike nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a.

2. Vendosjen e një periudhe tranzitore prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës afati i kryerjes së pagesave nga shoqëria OSHEE sh.a. për tregtarët fitues të ankandëve të



shitblerjes së energjisë elektrike me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë, mund të jetë jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë elektrike.

3. Pagesa që OSHEE-ja do të kryejë ndaj çdo tregtari me të cilin ka siguruar blerjen e energjisë të jetë proporcionale, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit për secilin tregtar, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë.

Vendimi sa më sipër erdhi në përgjigje të kërkesës së OSHEE sh.a., e cila me shkresën nr. 5477/1 prot., datë 8.3.2019, nisur nga situata financiare në të cilën ndodhej i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për vendosjen e një periudhe tranzitore, e konkretisht për procedurat e blerjes së energjisë që do të zhvillohen nga OSHEE sh.a. deri në fund të vitit 2019, duke kërkuar që pagesa e faturës së blerjes së energjisë elektrike të bëhet nga blerësi brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit, dhe jo brenda 90 ditëve siç parashikohet në Rregulloren e shitblerjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103/2016.

- Shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën nr. 13493 prot., datë 19.6.2019, paraqiti në ERE një kërkesë për zgjatjen e periudhës tranzitore të vendosur me pikën 2 të vendimit nr. 46, datë 19.3.2019, të bordit të ERE-s, deri në fund të vitit 2019.

- Nga ky komunikim i OSHEE sh.a. bëhet me dije se ka paguar deri në fillim të muajit qershor, gjithë detyrimet për blerjen e energjisë nga tregu i lirë deri në muajin dhjetor 2018 dhe pjesërisht ato të muajit janar 2019 ose rreth 50% të detyrimit prej rreth 38 milionë euro kosto energjie blerë në treg të lirë gjatë muajit janar 2019.

OSHEE sh.a. kërkesën e saj sa më sipër, e mbështet dhe e argumenton si në vijim:

- Për shkak të rritjes së kostove të blerjes së energjisë elektrike të cilat ishin 5.7 miliardë lekë më të larta se ato të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar dhe 6.4 miliardë lekë më të larta se ato të planifikuara, rezultati financiar i 4-mujorit të parë 2019 ishte negativ për -2.8 miliardë lekë me gjithë uljen e ndjeshme të shpenzimeve në krahasim me ato të planifikuara dhe rritjen e të ardhurave prej 5.2%.

- Treguesit kryesorë të 4-mujorit të parë të vitit 2019 u paraqitën në mënyrë të detajuar tabelore.

- Kosto e lartë e blerjes së energjisë elektrike krijoi vështirësi të madhe likuiditeti në OSHEE

gjatë periudhës 4-mujore, të cilat, megjithëse u “zbutën” nga lidhja e kontratave me afat pagese 180-ditore, nuk e kanë shmangur riskun e larë të likuiditetit me të cilën OSHEE-ja po përballlet.

- Parashikimet e motit akoma nuk sigurojnë ndryshime thelbësore në situatën hidrike dhe prodhimi i KESH-it pritët të jetë konsiderueshëm nën mesataren historike të planifikuar në buxhetin e vitit 2019 me vetëm 2.6 TWh energji e parashikuar të prodhohet.

- Nëse kontratat e blerjes së energjisë do të ishin me afate 90-ditore OSHEE-ja do të përballej me paaftësi të lartë likuiduese të pasqyruara të detajuara në mënyrë tabelore në kërkesën e saj.

- Shtyrja e afateve të pagesës së detyrimeve për blerjen e energjisë elektrike është në vetvete një nga masat e marra për të zbutur efektet e humbjeve financiare për shkak të rritjes së kostos së blerjes së energjisë elektrike në kushtet e uljes së prodhimit të KESH-it. Këshilli Mbikëqyrës me propozim të administratorit të OSHEE-së pasi u njoh me situatën e supozuar me vendimin nr. 6, datë 8.3.2019 vendosi pezullimin e pjesshëm të planit të investimeve për vitin 2019. Kjo masë u gjykua e domosdoshme me gjithë pasojat që mund të ketë në planin e uljes së humbjeve në rrjet, i cili ka varësi të drejtpërdrejtë nga sasia dhe cilësia e investimeve.

- OSHEE sh.a., ka marrë masa për shtyrjen në një kohë të mëvonshme të projekteve dhe shpenzimeve jo me rëndësi jetike për OSHEE sh.a., duke kryer vetëm shpenzime të domosdoshme, në mënyrë që siguria e shërbimit cilësor ndaj klientëve, të mos ndërpritet. Gjatë 4-mujorit të parë 2019 shpenzimet operative ishin 17% më të ulëta se ato të planifikuara me një kursim prej 805 milionë lekë.

- OSHEE-ja i është drejtuar Ministrisë së Financave për ta asistuar në shlyerjen 100% të detyrimeve të papaguara të energjisë ndaj OSHEE-së, nga institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore (ujësjellës etj.) me qëllim përballimin e situatës së krijuar.

Për gjithë sa më sipër shpjeguar e argumentuar,

- Duke vlerësuar se situata financiare dhe hidrologjike, në muajt e verës nuk garanton një parashikim optimist të situatës së furnizimit më energji elektrike nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. në zbatim të detyrimeve të kësaj të fundit për të



siguruar pjesën më të madhe të nevojës për furnizim me energji elektrike me sasi e çmime të rregulluara nga kontrata e miratuar mes palëve.

- Duke vlerësuar se periudha tranzitore e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 46, datë 19.3.2019 lehtësoi situatën financiare të OSHEE-së duke parandaluar rrezikun e pamundësisë së aftësisë paguese dhe shmangur akumulimin e penalteteve për mos likuidim në kohë të detyrimeve dhe nuk cenoi numrin e tregtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të energjisë elektrike nga OSHEE sh.a.

- Duke marrë në konsideratë parashikimet e nenit 180 të Kodit të Procedurave Administrative që sanksionon ndër të tjera se: Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur:

a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkakut të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin publik;

- Për shkak të rëndësisë së madhe të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike si i ngarkuari me detyrimin e shërbimit publik që lidhet me furnizimin e klientëve fundorë, stabiliteti i tij, garanton një performancë më të mirë dhe për rrjedhojë tutelon edhe qëndrueshmërinë e shërbimit për klientët fundorë.

- Duke vlerësuar se argumentet sipërcituar legjitimojnë e arsyetojnë kërkesën e OSHEE sh.a., por nuk mjaftojnë për të mbështetur në tërësi kërkesën e OSHEE sh.a. për shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 46 datë 19.3.2019, për të gjithë periudhën e kërkuar, deri në 31.12.2019.

- Pasi dëgjoi qëndrimin dhe argumentet e palëve të interesit, të përfaqësuar nga OSHEE sh.a. dhe përfaqësuesi i shoqërisë GEN-i Tiranë sh.p.k. në lidhje me këtë kërkesë.

- Vlerësoi të drejtë qëndrimin e përfaqësuesit të shoqërisë GEN-i Tiranë sh.p.k. për pranimin e pjesshëm të kërkesës së OSHEE sh.a. për shtyrjen e afatit jo më shumë se 3 muaj.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 46, datë 19.3.2019 “Mbi kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a., për

shtyrjen për një periudhë tranzitore të afatit të pagesës së faturave për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar, nga ana e OSHEE sh.a. dhe çështje të tjera të rregullimit”, deri më 30.9.2019.

2. Vijimin e pezullimit të zbatimit të nenit 20, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103 datë 23.6.2016, për shoqërinë OSHEE sh.a. sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Paga që OSHEE-ja do të kryejë ndaj çdo tregtari me të cilin ka siguruar blerjen e energjisë elektrike të jetë proporcionale, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit për secilin tregtar, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë.

4. OSHEE sh.a. të informojë periodikisht në ERE në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi dhe masat e marra për shterimin e mjeteve të tjera ligjore, për sigurimin e burimeve të financimit me kostot me të ulëta, për garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike.

5. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSHEE sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGES DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Adriatik Bego



VENDIM
Nr. 98, datë 21.6.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE TË SHOQËRISË OSHEE
SHA PËR VITIN 2019 DHE
PËRDITËSIMIT TË PLANIT TË
ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË
SHPËRNDARJES PËR PERIU DHËN
PESËVJEÇARE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, geramat “a” dhe “e” dhe nenit 75, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës në lidhje me kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për miratimin e planit të investimeve të shoqërisë OSHEE sh.a. për vitin 2019 dhe planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2019–2023 të shoqërisë OSHEE sh.a.,

konstatoi se:

- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., me shkresën nr. 1708 prot., datë 22.1.2019, ka paraqitur pranë ERE-s, Planin e Investimeve për vitin 2019.

- Me urdhrin nr. 14, datë 1.2.2019 të kryetarit të ERE-s, është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e aplikimit të dërguar nga shoqëria nëpërmjet shkresës së sipërcituar.

- Nga shqyrtimi i kryer, rezultoi se nga materiali i paraqitur, mungonin disa të dhëna ose janë paraqitur në mënyrë të përciptë dhe konkretisht:

- Mungon plani i përditësuar i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 5-vjeçare.

- Mungon paraqitja e statusit të realizimit të investimeve të miratuara për vitin 2018.

- Investimet e parashikuara nuk shoqërohen me relacione shpjeguese sipas kërkesave të rregullores.

- Efektet e pritshme të çdo investimi të parashikuar, nuk janë të qarta për të gjykuar.

- Lista e investimeve është paraqitur në formën e buxhetimit në disa zëra.

- Nevojitet informacion më i detajuar lidhur me investimet e parashikuara që nuk janë realizuar.

- Nevojitet informacion lidhur me investimet që nuk janë parashikuar, por janë realizuar.

- Nevojitet informacion lidhur me kapitalizimin e investimeve të realizuara.

- Me shkresën nr. 69/1, prot., datë 5.4.2019, ERE i ka kërkuar OSHEE sh.a., që të bëjë me dije çdo komunikim me këshillin mbikëqyrës që lidhet me procesin e miratimit të Planit të Investimeve dhe Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes.

- Në vijim, OSHEE sha, me shkresën nr. 1708/2, datë 17.4.2019, ka ripërcjellë në ERE, kërkesën për shqyrtim të Planit të Investimeve për vitin 2019, pjesë e programit financiar të shoqërisë OSHEE sh.a., së bashku me kërkesën për pezullimin e një pjese të Planit të Investimeve për vitin 2019, si rezultat i situatës aktuale të furnizimit me energji elektrike dhe kopje të vendimit nr. 6, datë 8.3.2019, të Këshillit Mbikëqyrës, mbi pezullimin e Planit të Investimeve të vitit 2019.

- Me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 31, datë 7.5.2019, është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e Planit të Investimeve për vitin 2019 dhe përditësimit të Planit të Zhvillimit të Rrjetit të shpërndarjes të shoqërisë OSHEE sh.a.

- Nga rishqyrtimi i kryer, rezulton se, në materialin e paraqitur në tërësi, mungojnë të dhëna të tjera ose janë paraqitur në mënyrë të përciptë dhe konkretisht:

- Nuk ka argumentime të detajuara se si këto investime të parashikuara, ndikojnë në rritjen e shkallës së sigurisë së sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Kriteret e planifikimit dhe zhvillimit të sistemit të shpërndarjes nuk paraqiten sipas përcaktimeve të Kodit të Shpërndarjes.

- Mungon informacion për vlerësimin e treguesve për zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

- Mungon raporti vjetor i zbatimit të Planeve të Investimeve të vitit paraardhës.

- Nuk dokumentohet që ky Plan Investimesh të jetë konsultuar me palët e interesuara.

- Investimet e parashikuara për 2019, nuk shoqërohen me analizën kosto-përfitim.

- OSHEE sh.a. ka paraqitur në ERE, Planin e Zhvillimit të Rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2019–2023.



- Me vendimin nr. 182, datë 20.8.2018, bordi i ERE-s, është shprehur mbi miratimin e Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018–2022)

- Për këtë arsye, plani i përditësuar i investimeve, duhet t'i korrespondojë periudhës përkatëse rregullatore.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a., për miratimin e Planit të Investimeve të shoqërisë për vitin 2019 dhe përditësimin e Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 182, datë 20.8.2018.

2. OSHEE sh.a., të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe informacionin e munguar sipas të gjitha konstatimeve në këtë vendim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit si dhe të përditësojë Planin e Zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2018–2022, siç është miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 182, datë 20.8.2018.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Dhomën Kombëtare të Tregtisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Adriatik Bego**

VENDIM Nr. 99, datë 21.6.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWER AND GAS OPERATIONS” PGO SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; të ndryshuar neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Shoqëria “Power and Gas Operations” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 308 prot., datë 23.4.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 71, datë 10.5.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Pas kësaj vendimarrje, me shkresën nr. 32/30 prot., datë 10.5.2019, u bë njoftimi në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 308/1 prot., datë 14.5.2019, iu dërgua subjektit njoftim për vendimin dhe kërkesa për plotësimin e mungesave të konstatuara në dokumentacion.

- Shoqëria “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 308/3, datë 28.5.2019, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,



rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikimet (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendrike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 100, datë 21.6.2019

PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE STANDARDE DHE KËRKESAVE MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT DHE FURNIZIMIT TË RRJETEVE TË GAZIT NATYROR”

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16, pika 18, nenit 17, pika 3, nenit 48, pika 5, nenit 53 pika 5, nenit 89, pikat 1 dhe 7, nenit 89, nenit 94 pikat 5 dhe 8, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”,

konstatoi se:

- ERE në zbatim të nenit 41, pika 1, gjerat “h” të direktivës 2009/73/EC e transpozuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, në nenin 16, pika 18, ka detyrimin për të vendosur ose miratuar standardet dhe kërkesat për cilësinë e shërbimit dhe të furnizimit në sektorin e gazit.

- ERE, me vendimin e bordit nr. 53, datë 3.4.2019 filloi procedurën për miratimin e “Rregullores për kriteret standarde minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.

- ERE në vijim të kësaj vendimmarrje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, me shkresën nr. 32/13 prot., datë 3.4.2019, publikoi për tre ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure, në përfundim të afatit të njoftuar, rezultoi që nuk kishte asnjë koment apo opinion nga palët e interesuara.



- ERE, me shkresën nr. 279 prot., datë 5.4.2019, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe Autoritetit të Konkurrencës, për njoftimin e këtij vendimi dhe marrjen e opinioneve apo komenteve.

- ERE, gjithashtu, nëpërmjet postës elektronike ju drejtua për marrjen e opinioneve apo komenteve edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo opinioneve, rezultoi se Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, nëpërmjet *e-mail*-it të datës 8.5.2019, ka përcjellë pranë ERE-s komente në lidhje me këtë draft të cilat janë marrë kryesisht në konsideratë nga ERE dhe argumentuar si më poshtë:

- Për nenin 2, “Qëllimi i rregullores”, pika 2.3, Sekretariati ka rekomanduar që zbatimi i kësaj rregulloreje duhet të përfshijë të gjithë furnizuesit pa diskriminim. Ky koment u pranua dhe u pasqyrua në pikën 2.3 të draftit të rregullores, pas konsultimit me furnizuesit të cilët u njoftuan nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 279/4 prot., datë 6.6.2019.

- Për nenin 3 “Përkufizimet”, në lidhje me përkufizimin “Treguesit e performancës minimale të cilësisë”, Sekretariati ka rekomanduar që të titullohet “Standardet e performancës minimale të cilësisë”, duke qenë se janë më tepër sesa tregues. Ky koment u pranua dhe u pasqyrua në gjithë përmbajtjen e draftit të rregullores.

- Në nenin 5 “Matja, regjistrimi, publikimi dhe raportimi i QPI”, pika 5.2, Sekretariati ka rekomanduar se do të ishte e rëndësishme që rregullatori të koordinojë në mënyrë aktive dhe të sigurojë mjetet e pajtueshme për të mundur aksesin në të dhënat aktuale dhe historike, duke përcaktuar udhëzimet përkatëse në këtë rregullore. Sipas Sekretariatit, një qasje e pakoordinuar mund të çojë në zgjidhje të ndryshme të teknologjisë së informacionit. Kjo mund ta bëjë shumë më të vështirë për ERE-n që të vendosë një sistem monitorimi për shkak të ndryshimeve të mëdha në të dhënat dhe zgjidhjet e IT-së ndërmjet OSSH-së dhe OST-së. Sa i përket këtij komenti të Sekretariatit, shpjegojmë se në këtë rregullore nuk mund të parashikohen udhëzime për raportimin e të dhënave nga të licencuarit, pasi ERE do të miratojë si dokument të veçantë udhëzuesin e raportimit në të cilin do të parashikojë dhe formatin e raportimit të të dhënave. Formatin që do

të miratojë ERE do t'i japë zgjidhje këtij shqetësimi të Sekretariatit e për këtë arsye nuk është e nevojshme të shtohet ndonjë paragraf lidhur me këtë propozim.

- Sekretariati ka komentuar se ERE duhet të kryejë një monitorim të vazhdueshëm në lidhje me publikimin e të dhënave. Në vijim të këtij komenti në fund të paragrafit 5.2 është shtuar fjalia si vijon: “Sa më sipër nuk shmang detyrimin e ERE-s për monitorimin e të licencuarve”.

- Për nenin 7.2 “Monitorimi dhe mbikëqyrja”, Sekretariati ka rekomanduar vendosjen e referencave konkrete të neneve të ligjeve në lidhje me përgjegjësinë që do të mbajnë të licencuarit, klientët dhe të gjithë personat përgjegjës. Komenti u pranua dhe në këtë pikë të rregullores u shtuan referencat respektive: neni 106, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe neni 107, i ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Për nenin 8 “Gjobat në rast të mospërbushjes së MQPS-së” (“Standardet e performancës minimale të cilësisë”), Sekretariati ka rekomanduar që në rastin e mospërbushjes nga ana e OSSH-së e MQPS-ve të përcaktuar në këtë Rregullore, ERE duhet të vendos një penalitet që paguhet nëpërmjet reduktimit të tarifave ose penalitete të cilat paguhen si kompensim direkt për klientët. Edhe nëse ERE nuk parashikon akoma të vendosë kompensim të drejtpërdrejtë për klientët, do të kishte kuptim të konsiderohej për një moment të dytë, pasi të përfundojë monitorimin. Në lidhje me këtë koment të Sekretariatit vërehet se ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; “Rregullorja për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave” dhe “Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, nuk parashikojnë uljen e tarifave si penalitet, dhe si e tillë në një kohë të dytë ERE mund të miratojë një rregullore në të cilën të parashikohet masa e kompensimit të klientëve rast pas rasti. Rekomandimi i Sekretariatit do të pasqyrohet në ndryshimet që do të bëhen në kontratën Tip që ERE do të mrratojë në zbatim të nenit 16, pika 10, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

Në vijim të sqarimit sipërcituar, nuk merret në konsideratë edhe propozimi i Sekretariatit për të shtuar pikën 8.2 në këtë nen, me përmbajtjen si



vijon: “Jo më herët se në nëntori 2023, ERE do të vlerësojë dhe publikojë një raport mbi efektivitetin e gjobave, të cilat janë vendosur nga ajo kohë, në përmirësimin e cilësisë minimale të performancës. Në këtë raport, ERE do të shqyrtojë gjithashtu rëndësinë dhe mundësinë e përfshirjes së kompensimeve direkte nga pjesëmarrësit e tregut tek klientët në rast të mos përmbushjes së kërkesave standarde minimale”.

Po në nenin 8, Sekretariati ka sugjeruar përcaktimin e nivelit të gjobave dhe masën e kompensimit për çdo komponent (standard ose tregues minimal), veç e veç. Në vijim të këtij komenti, është shtuar në fund të këtij neni edhe “Rregullorja për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, duke qenë se kjo rregullore parashikon masën e gjobës për çdo shkellje.

- Për nenin 9 “Mospërmbushja për shkak të forcës madhore”, Sekretariati ka shtuar në fund të paragrafit 9.3, si vijon: “ERE gjithashtu mund të hetojë dhe rishikojë arsyetimin e mosrespektimit të MQPS-së për shkak të forcës madhore, me iniciativën e saj, pa pasur referencë të çështjes nga palët e prekura.” Në lidhje me këtë koment, sqarojmë se ligji për sektorin e gazit natyror, nuk parashikon që ERE të vlerësojë rastet e forcës madhore, pasi një vlerësim të tillë e bën vetëm Gjykata. Si e tillë komenti i Sekretariati nuk merret në konsideratë.

- Në nenin 10, “Dispozita kalimtare”, Sekretariati ka komentuar se: “është detyrë e ERE-s të përfshijë mekanizma incentivues në lidhje me cilësinë e performancës në Metodologjinë e Tarifave të Transmetimi dhe Shpërndarjes”. Në lidhje me këtë koment vlen të sqarojmë se në praktikën rregullatore të vendeve të tjera si dhe për analogji nga Metodologjia e Llogaritjes së tarifave të OSSH sh.a. të energjisë elektrike, konstatojmë se parashikohet faktorin X (faktorin i përmirësimit të eficiencës së vendosur nga ERE) dhe faktorin Q (Faktorin i përmirësimit të performancës, bazuar në cilësinë e furnizimit të klientëve fundorë). Si i tillë rekomandimi i Sekretariatit do të merret parasysh nga ERE në rastin e rishikimit të Metodologjisë përkatëse të tarifave.

- Në shtojcën 1 “Standardet e performancës minimale të cilësisë”, në kolonën “Niveli i pritshëm i performancës”, Sekretariati ka shtuar fjalët “Jo më pak se...” të cilat u pranuan dhe pasqyruan në tabelë.

- MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 279/1, datë 13.5.2019, ka shprehur dakordësinë e saj në parim për miratimin e kësaj rregulloreje dhe sugjeron si më poshtë:

- Titulli të bëhet: “Kriteret standarde dhe kërkesat minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”, në përputhje me pikën 18, të nenit 16, të ligjit nr. 201/2015. Të njëjtin sugjerim kemi edhe për nenin 2.1. Komenti i MIE-s u pranua dhe u pasqyrua në rregullore.

- Rishikimin e afateve të përcaktuara në nenin 10, duke qenë se “Albgaz” sh.a. nuk ushtron veprimtarinë e tij si operator i shpërndarjes dhe duke marrë parasysh që TAP do të fillojë operimin e tij në 2020, afatet e përcaktuara në këto pikat 10.1 dhe 10.2 të nenit 10 të shtyhen me të paktën 1 ose 2 vjet, pasi akoma nuk kemi një sistem të shpërndarjes së gazit natyror. Në lidhje me sa më sipër, mendojmë se afatet e vendosura në këtë rregullore, janë të tilla që të shërbejnë si incentivë për shoqëritë që të arrijnë objektivat përkatëse. Këto afate janë vendosur në konsulencë me USAID dhe gjatë periudhës së pritjes së komenteve nga palët kanë marrë edhe dakordësinë e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë i cili e ka vlerësuar këtë rregullore si shumë cilësore. Edhe vetë shoqëria “Albgaz” sh.a. ka bërë me dije se i gjen të drejta parashikimet e dispozitave të kësaj rregulloreje. Mospërmbushja brenda afateve të objektivave të parashikuara në këtë rregullore, nuk pengon shoqëritë që t’i drejtohen ERE-s me një kërkesë për shtyrjen e tyre, duke argumentuar e provuar pamundësinë e realizimit në kohë.

Përtej propozimit të MIE-s, duke argumentuar mungesën e rrjetit të shpërndarjes së gazit aktualisht, dispozita të ngjashme në rrethana të ngjashme janë përcaktuar nga ERE në bashkëpunim me palët e interesit edhe në sektorin e energjisë elektrike, në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, apo atë të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.

- MIE sugjeron që terminologjia e përdorur në këtë rregullore duhet të jetë e unifikuar me atë të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. MIE i referohet këtu terminologjisë së përdorur në rregullore “Konsumatori” ndërkohë që sipas ligjit duhet të jetë “Klient”. Ky koment u pranua dhe u reflektua kudo në rregullore.



- Të riformulohet “Tubacion kryesor” për të qenë me i kuptueshëm. Duke qenë se MIE nuk ka përcjellë një propozim konkret mbi riformulimin e këtij përkufizimi, sugjerimi nuk merret në konsideratë.

- “Albgaz” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 279/2, datë 14.5.2019, ka shprehur dakordësinë e saj me draftin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”, por nuk është shprehur në lidhje me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, gjë e cila iu kërkua në mënyrë të veçantë nga ERE.

- Me kërkesë të bordit të ERE-s, me shkresën nr. 279/4 prot., datë 6.6.2019, ERE iu drejtuar për marrje mendimi edhe shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., e cila nuk ka shprehur asnjë mendim në lidhje me këtë rregullore.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Adriatik Bego

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE STANDARDE DHE KËRKESAVE MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT DHE FURNIZIMIT TË RRJETEVE TË GAZIT NATYROR

PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Kjo Rregullore është hartuar në përputhje me nenin 16, pika 18, nenin 48, pika 5, nenin 53 pika 5, nenin 89, pika 1 dhe 7, nenin 94 pikat 5 dhe 8 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e klientit”.

Neni 2 Qëllimi i rregullores

2.1 Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror tek klienti fundorë.

2.2 Duke pasur parasysh se përkufizimi i pranuar gjerësisht prej industrisë për “Cilësinë e shërbimit dhe furnizimit” në fushën e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të gazit natyror është i gjerë, kjo rregullore nuk duhet të zbatohet si një dokument i veçantë, por bashkërisht me;

a) Kushtet e licencave për shërbimet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit;

b) Kodin e Transmetimit të Gazit natyror, Kodin e Shpërndarjes së Gazit natyror, Kodin e Matjes të Gazit natyror dhe çdo Kod tjetër përkatës;

c) Standardet Teknike të Cilësisë dhe të Sigurisë të hartuara dhe miratuara nga Këshilli i Ministrave (ose në proces hartimi) në përputhje me nenin 10, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të njohura edhe si rregullat teknike të gazit (kodet e praktikës për sektorin shqiptar të gazit);

d) “Standardet për trajtimin e ankesave të klientëve nga të licencuarit në veprimtaritë e shpërndarjes dhe furnizimit të gazit natyror për klientët me pakicë”, që miratohet nga ERE;



e) “Rregulloren për trajtimin e ankesave të dorëzuara nga klienti dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve, për sektorin e energjisë dhe gazit natyror”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016;

f) Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes; dhe

g) Çdo legjislacion tjetër përkatës dhe të zbatueshëm.

2.3 Kjo rregullore zbatohet për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST-G), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-G), Furnizuesit përgjegjës për Detyrimin e Shërbimit Publik në përputhje me nenin 89 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe çdo furnizues tjetër i gazit natyror.

Neni 3 Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e parashikuar në këtë nen, ndërkohë që çdo term tjetër që nuk është përcaktuar në këtë rregullore, ka të njëjtin kuptim me termit e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”:

“**Furnizues**” do të thotë një shoqëri e licencuar për të kryer aktivitetin e furnizimit me gaz natyror;

“**Indeksi i kohëzgjatjes mesatare së ndërprerjes për klientin**” ose “**CAIDI**” është një tregues i performancës i përcaktuar në nenin 4.7 të kësaj rregulloreje për të vlerësuar kohëzgjatjen mesatare të ndërprerjes për klientët e prekur.

“**Indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjes për klientin**” ose “**CAIFI**” është një tregues i performancës i përcaktuar në nenin 4.8 të kësaj rregulloreje që përdoret për të vlerësuar frekuencën (shpeshhtësinë) mesatare të ndërprerjeve për klientët e prekur.

“**Klient**” nënkupton një klient me shumicë, ose një klient fundor të gazit natyror ose një shoqëri të gazit natyror, i cili blen gaz natyror;

“**Baza e klientëve**” ose “**CB**” në lidhje me një periudhë përkatëse (vit, gjashtë muaj ose tremujor) nënkupton numrin mesatar të klientëve të furnizuar të përllogaritur sipas formulës së mëposhtme:

$$CB = \frac{A + B}{2}$$

Ku:

CB = baza e klientëve për periudhën përkatëse

A = numri total i klientëve të shpërndarjes në fillim të periudhës përkatëse.

B = numri total i klientëve të shpërndarjes në fund të periudhës përkatëse.

“**Klient familjar**” nënkupton një klient që blen gaz natyror për konsum familjar dhe përjashton një klient që përdor gaz natyror për çdo aktivitet tregtar ose profesional.

“**Tubacion kryesor**” është një tubacion me diametër të madh, pjesë e sistemit të shpërndarjes, që shërben për të përcjellë dhe shpërndarë gazin natyror drejt tubacioneve me diametra më të vegjël për të klientët fundorë dhe familjarë.

“**Ndërprerje**” nënkupton çdo humbje të furnizimit me gaz natyror për klientët që lidhet me një mosfunksionim të ndonjë pjese të rrjetit, përfshirë edhe ndërprerjet në mjediset e një Klienti të vetëm, por duke përjashtuar ndërprerjet e shkaktuara nga një furnizues dhe/ose shitës me pakicë ose nga një defekt në pajisjet për gazin natyror në pronësi të një Klienti, dhe duke pasur parasysh që:

- fillimi i ndërprerjes supozohet të ketë ndodhur kur ndërprerja fillimisht është regjistruar automatikisht nga pajisje të tilla si SCADA ose, në rastet kur pajisje të tilla nuk ekzistojnë, në kohën kur ndërprerja vihet re fillimisht (në çfarëdo mënyre) nga OSSH-G ose OST-G, ose kur klienti i parë raporton se ka pasur një ndërprerje në rrjet; dhe

- përfundimi i një ndërprerjeje supozohet të ketë ndodhur kur ndërprerja automatikisht regjistrohet si e përfunduar nga pajisje të tilla si SCADA ose, në rastet kur pajisje të tilla nuk ekzistojnë, në kohën kur furnizimi me gaz natyror i kthehet të gjithë klientëve të prekur³.

“**Ndërprerje e Planifikuar**” do të thotë një ndërprerje e parashikuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe/ose të Shpërndarjes së gazit natyror të shërbimit kur klienti/ët është/janë njoftuar paraprakisht për ndërprerjen në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi, kodet e rrjetit, rregullat dhe rregulloret.

“**Ndërprerje e paplanifikuar**” do të thotë një ndërprerje që nuk është parashikuar nga ana Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe/ose të Shpërndarjes.

³ Mundet që numri i klientëve të prekur gjatë një ndërprerjeje të duhet të përllogaritet.



“Ndërprerje e zgjatur” nënkupton një ndërprerje të furnizimit me gaz natyror të një klienti në pikën e tij të furnizimit e cila ka një kohëzgjatje më të gjatë se 30 minuta, duke pasur parasysh që përfundimi i ndërprerjes së zgjatur do të jetë momenti i rikthimit të plotë të furnizimit për klientin. Përsëritja në një periudhë të shkurtër kohore e tri ose më shumë ndërprerjeve me kohëzgjatje jo më të shkurtër se 15 minuta, do të konsiderohet gjithashtu si ndërprerje e zgjatur.

“Standardet e performancës së cilësisë” ose “QPI” janë parametra të paracaktuar të përdorura për të matur nivelin e performancës së shërbimeve dhe furnizimit të gazit natyror prej të licencuarve siç përcaktohet në nenin 4 të kësaj rregulloreje dhe aktet e tjera rregullatore përkatëse të sektorit të gazit natyror.

“Standardet e performancës minimale të cilësisë” ose “MQPS” nënkupton nivelet minimale të QPI-së, të miratuara kohë pas kohe nga Bordi i ERE-s për një periudhë rregullatore specifike dhe të bashkangjitur kësaj rregulloreje si shtojca 1.

“Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes së sistemit” ose “SAIDI” është një tregues i performancës i përcaktuar në nenin 4.5, i përdorur për të vlerësuar kohëzgjatjen mesatare të ndërprerjeve të zgjatura për të gjithë bazën e klientëve.

“Indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjes së sistemit” ose “SAIFI” është një tregues i performancës i përcaktuar në nenin 4.6, i përdorur për të vlerësuar frekuencën/shpeshtësinë mesatare të ndërprerjeve të zgjatura për të gjithë bazën e klientëve.

“Skema stimuluese për performancën e cilësisë” është një skemë financiare nxitëse që ERE mund të miratojë në përputhje me këtë rregullore me qëllim që të shpërblejë OSSH-G-në dhe të licencuar të tjerë në sektorin e gazit për përmirësimin e cilësisë së performancës së tyre në shërbime dhe furnizim.

PJESA II

STANDET E PERFORMANCËS SË CILËSISË & ZBATIMI

Neni 4

Standardet e Performancës së Cilësisë

Standardet e performancës për vlerësimin e cilësisë së shërbimit dhe furnizimit në lidhje me një periudhë të caktuar (vit, gjashtë mujor ose tremujor) që duhet të maten, regjistrohen dhe/ose llogariten nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe/ose të Shpërndarjes cilido qoftë dhe të raportohen në ERE në përputhje me nenin 5 janë si vijon:

4.1 “Indeksi i rrezikut të rrjedhjeve të gazit” përbëhet nga numri i rrjedhjeve të gazit të raportuara nga klientët ose palët e treta gjatë periudhës përkatëse. Për të qenë të qartë, raportimet nga palë të treta të ndryshme për të njëjtën rrjedhje gazi do të konsiderohen si një rast i vetëm i rrjedhjes së gazit.

4.2 “Efikasiteti i reagimit ndaj thirrjeve emergjente në lidhje me rrjedhjet e gazit” do të thotë përqindja e rasteve që OSSH-G ka arritur në vendngjarje brenda afatit prej 90 minutash nga marrja e raportimit.

4.3 “Përqindja e klientëve me lexim faktik të matjes” ose “MC” llogaritet me anë të formulës së mëposhtme;

$$MC(\%) = \left(1 - \frac{NMC}{CB}\right) * 100\%$$

Ku:

MC = përqindja e klientëve që maten ose e klientëve me lexim faktik të matjes (lexim në distancë ose vizual) si përqindje e bazës së klientëve.

NMC = klientë që nuk maten ose numri total i klientëve pa lexim të matjes. Kjo përfshin edhe klientët me matës të dëmtuar ose teknikisht me defekt në momentin e raportimit të të dhënave nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, por përjashton klientët të cilët e kanë raportuar leximin e matësit të tyre tek OSSH.

CB = Baza e klientëve siç përcaktohet në nenin 3.

4.4 “Performanca e njoftimit për ndërprerjet e planifikuara” ose “PPI” do të thotë përqindja e rasteve të njoftuara brenda periudhës së aprovuar dhe të publikuar për njoftim, e cila për qëllime të



kësaj rregulloreje do të jetë 5 ditë kalendarike përpara për çdo rast ndërhyrjeje të planifikuar për mirëmbajtje, riparim, lidhje apo tjetër.

$$PPI(\%) = \left(1 - \frac{NNPI}{TPI}\right) * 100\%$$

Ku:

NNPI = numri total i ndërprerjeve të planifikuara të pa-njoftuara që kanë ndodhur duke përfshirë edhe ato të informuara paraprakisht, por me më pak se 5 ditë kalendarike.

TPI = numri total i ndërprerjeve të planifikuara të realizuara duke përfshirë si ato të njoftuara ashtu edhe ato të panjoftuara.

4.5 “Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes së sistemit” ose “SAIDI” do të thotë shuma e kohëzgjatjeve të të gjitha ndërprerjeve të zgjatura (në minuta) që kanë ndodhur gjatë periudhës përkatëse të pjesëtuar nga baza e klientëve, sipas formulës në vijim;

$$SAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K (D_i \times N_i)}{CB}$$

Ku:

D_i = kohëzgjatja e ndërprerjes të Zgjatur “i”

K = numri total i ngjarjeve të ndërprerjeve të zgjatura.

N_i = numri i klientëve që vuajnë nga ndërprerja e zgjatur “i”

CB = baza e klientëve, siç përcaktohet në nenin 3.

4.6 “Indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjes së sistemit” ose “SAIFI” do të thotë numri i përgjithshëm i ndërprerjeve të zgjatura i pjesëtuar nga baza e klientëve të shërbyer gjatë periudhës përkatëse sipas formulës në vijim dhe jep informacion mbi frekuencën/shpeshtësinë mesatare të ndërprerjeve të zgjatura për klient në një zonë të paracaktuar.

$$SAIFI = \frac{K}{CB}$$

Ku:

K = numri total i ngjarjeve të ndërprerjeve të zgjatura.

CB = baza e klientëve, siç përcaktohet në nenin 3.

4.7 “Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes së klientit” ose “CAIDI” nënkupton kohëzgjatjen totale të të gjitha ndërprerjeve të zgjatura (në minuta) të pjesëtuar me numrin total të

ndërprerjeve të zgjatura që kanë ndodhur gjatë periudhës përkatëse, e cila është ekuivalente me pjesëtimin e indeksit SAIDI me indeksin SAIFI. Ky tregues përfaqëson kohën mesatare për të rivendosur furnizimin e klientëve pas një ngjarje të ndërprerjes së zgjatur të furnizimit me gaz natyror dhe duhet të raportohet për të dyja; për çdo tubacion kryesor dhe për të gjithë rrjetin e shpërndarjes.

$$CAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K D_i \times N_i}{K} = \frac{SAIDI}{SAIFI}$$

Ku:

N_i = numri i klientëve që vuajnë nga ndërprerja e zgjatur “i”.

D_i = kohëzgjatja e ndërprerjes së zgjatur “i”.

K = numri total i ngjarjeve të ndërprerjeve të zgjatura.

4.8 “Indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjes së klientit” ose “CAIFI” do të thotë numri i përgjithshëm i ndërprerjeve të zgjatura i pjesëtuar nga numri i klientëve të prekur nga ndërprerjet e zgjatura siç tregohet më poshtë. Përdoret për të treguar tendencat e ndërprerjeve të klientët dhe ndihmon për të treguar numrin e klientëve të prekur në krahasim me të gjithë bazën e klientëve.

CAIFI

$$= \frac{\text{Numri total i Ndërprerjeve të Zgjatura}}{\text{Numri i klientëve të prekur}}$$

4.9 “Indeksi i performancës për përgjigjen ndaj ankesave të klientit” ose “PICC” do të thotë përqindja e klientëve që për ankesat e paraqitura kanë marrë përgjigje brenda afatit të përcaktuar në “Standardet e trajtimit të ankesave të klientëve të sektorit të gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit për klientët me pakicë”, të miratuara nga Bordi i ERE-s. Ky tregues zbatohet për të gjitha ankesat e klientëve së bashku pavarësisht nga natyra e tyre specifike duke përdorur formulën e mëposhtme;

$$PICC(\%) = \left(1 - \frac{NRC}{TNC}\right) * 100\%$$

Ku:

NRC = numri i ankesave pa përgjigje.

TNC = numri total i ankesave të marra gjatë periudhës përkatëse.



4.10 “Indeksi i Performancës në Zgjidhjen e Ankesave të Klientëve në lidhje me Cilësinë e Presionit” ose “PIPQC” do të thotë përqindja e ankesave të klientëve që lidhen me devijimet e presionit jashtë marzheve të paracaktuar në Kodet e Rrjetit të Transmetimit dhe/ose të shpërndarjes të cilat janë zgjidhur nga OST-G dhe/ose OSSH-G brenda afatit të miratuar kohor. Ky tregues zbatohet vetëm për klientët me një konsum vjetor prej jo më pak se _____ MWh. Afatet e dhënies së përgjigjes përcaktohen gjithashtu në kodet e transmetimit dhe/ose shpërndarjes që do të miratohen nga Bordi i ERE-s.

$$PIPQC(\%) = \left(1 - \frac{NNFPQC}{TNPQC}\right) * 100\%$$

Ku:

PIPQC = indeksi i performancës ndaj ankesave të cilësisë së presionit;

NNFPQC = numri i ankesave të cilësisë së presionit të pa-zgjidhura brenda afatit kohor;

TNPQC = numri total i ankesave të cilësisë së presionit të marra gjatë periudhës përkatëse.

4.11 “Indeksi i performancës në zgjidhjen e kërkesave të klientit për lidhje të re” ose “PINC” do të thotë përqindja e kërkesave të klientit në lidhje me lidhjet e reja që janë plotësuar nga OSSH-ja brenda afatit kohor të parashikuar nga “Rregullorja për lidhjet e reja në sistemin (et) e transmetimit dhe/ose shpërndarjes” që do të miratohet nga Bordi i ERE-s dhe llogaritet sipas formulës së mëposhtme;

$$PINC(\%) = \left(1 - \frac{NDNC}{TRNC}\right) * 100\%$$

Ku:

PINC = indeksi i performancës ndaj kërkesave të klientëve për vendosjen e lidhjeve të reja

NDNC = numri i lidhjeve të reja të vonuara të cilat ose nuk janë vendosur ende ose janë vendosur përtej afatit kohor të miratuar;

TRNC = numri total i kërkesave për lidhjet e reja të marra gjatë periudhës përkatëse.

4.12 “Koha për të rilidhur klientët të cilëve u është shkëputur furnizimi me gaz natyror për shkak të mos pagesës së detyrimeve” ose “ARTL” është koha mesatare e marrë nga OSSH-G për të rilidhur klientin pas njoftimit prej furnizuesit për ta rilidhur atë.

$$ARTL = \frac{\sum_{i=1}^K Di}{Nt}$$

Ku:

Faqe | 7468

ARTL = Koha mesatare e rilidhjes së klientëve të shkëputur për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve

Di = koha e rilidhjes së klientit të shkëputur për shkak të mospagimit të detyrimeve “i” që matet si kohëzgjatja nga momenti kur Furnizuesi informon OSSH-G-në të rivendosë lidhjen derisa furnizimi të jetë realizuar dhe dokumentuar.

Nt = numri total i klientëve të shkëputur për shkak të mospagesës së detyrimeve.

Neni 5

Matja, regjistrimi, publikimi dhe raportimi i QPI

5.1 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, OST-G dhe çdo i licencuar tjetër janë përgjegjës për kryerjen e matjeve të nevojshme dhe disponueshmërisë e të gjithë të dhënave që duhen për llogaritjen e të gjithë treguesve të performancës së cilësisë të shërbimit dhe furnizimit të gazit natyror siç përcaktohet në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

5.2 Brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, por jo më vonë se janari 2021, OSSH-G, OST-G dhe çdo i licencuar tjetër përkatës do të ndërtojnë mjetet e përshtatshme duke përfshirë edhe mbi bazë IT (teknologji informacioni), të aftë për të regjistruar dhe për të mundësuar aksesin në të dhënat aktuale dhe ato historike të QPI-së. Gjithashtu, duke filluar nga kjo datë informacioni i publikuar do të strukturohet sipas nenit 4 dhe shtojcës 1 të kësaj rregulloreje në përputhje me praktikatat më të mira të industrisë në atë kohë. Në rast se informacioni në lidhje me një ose më shumë tregues nuk është i disponueshëm, OSSH-G, OST-G ose çdo i Licencuar tjetër përkatës do të informojë menjëherë ERE-n për këtë dhe do të paraqesë një afat të arsyeshëm për korrigjimin e situatës. Sa më sipër nuk shmang detyrimin e ERE-s për monitorimin e të licencuarve.

5.3 Përkufizimet e QPI-së dhe MQPS-së do të publikohen dhe përditësohen rregullisht në faqen e internetit të OSSH-së pas miratimit nga Bordi i ERE-s në përputhje me nenin 10.3. Udhëzuesi i Raportimit të të dhënave nga të licencuarit do të miratohet nga ERE.

5.4 Informacioni do të mbledhet dhe regjistrohet progresivisht gjatë gjithë vitit kalendarik dhe QPI



do t'i raportohet ERE-s jo më vonë se 30 ditë nga fundi i çdo tremujori.

5.5 Raportet tremujore, për tremujorin e dytë, të tretë dhe të katërt, do të përmbajnë përveç të dhënave specifike të tremujorit përkatës edhe shifrat progresive që nga fillimi i vitit përkatës.

5.6 Raportimi vjetor i QPI-së është pjesë përbërëse e raporteve vjetore të OST- G dhe OSSH – G dhe do të fillojë jo më vonë se raportimi për vitin 2021.

Neni 6

Menaxhimi i ankesave

6.1 OSSH-G do të krijojë një sistem të integruar të shërbimit të ankesave duke përfshirë një linjë telefonike 24/24h e cila ndër të tjera do të marrë dhe regjistrojë të gjitha ankesat e klientëve dhe do të sigurojë që ato të ndiqen në mënyrë të duhur dhe se procesi është regjistruar dhe është i gjurmueshëm.

6.2 OSSH-G do të trajtojë çdo ankesë të klientit në përputhje me “Standardet e trajtimit të ankesave të klientëve prej të licencuarve në aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me gazit natyror të klientëve me pakicë” të miratuara nga Bordi i ERE-s.

6.3 Klientët që nuk janë të kënaqur me zgjidhjen e ofruar nga i licencuari mund të ndjekin ankesën e tyre me ERE-n, e cila do ta trajtojë atë në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të dorëzuara nga klienti dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve, për sektorin e energjisë dhe gazit natyror”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

Neni 7

Monitorimi dhe mbikëqyrja

7.1 ERE, duke zbatuar kompetencat dhe përgjegjësitë e saj të dhëna me ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar duhet të sigurojë monitorimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e kësaj rregulloreje.

7.2 Të licencuarit, klientët dhe të gjithë personat përgjegjës, të cilët me veprimet ose mosveprimet e tyre nuk përmbushin kërkesat e Performancës Minimale të Cilësisë, të miratuara me këtë

Rregullore, janë përgjegjës sipas përcaktimeve të nenit 106 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 8

Gjobat në rast të mospërmbushjes së MQPS-së

8.1 Në përputhje me NENIN 10.2 të kësaj rregulloreje, në të gjitha rastet e mospërmbushjes nga ana e OSSH-G-së e MQPS-ve të përcaktuar në këtë RREGULLORE, OSSH-ja do të jetë subjekt i një gjobe sipas NENIT 106 (1) (a) (x) të LIGJIT nr. 102 / 2015 “Për SEKTORIN E GAZIT NATYROR”, të ndryshuar dhe “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”.

Neni 9

Mospërmbushja për shkak të një force madhore

9.1 Kur nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij të përcaktuara me anë të kësaj rregulloreje për shkak të një ngjarjeje të shkaktuar nga një forcë madhore, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të gjitha palët e prekura, duke dhënë detaje për shkaqet e dështimit dhe kohëzgjatjen e pritshme të kësaj pamundësie.

9.2 Gjatë periudhës së një force madhore aktive, detyrimet e OSSH-G-së për të përmbushur MQPS-në do të pezullohen.

9.3 Në rast se ndonjë nga palët e prekura nga mospërmbushja e MQPS-së nga ana e OSSH-G-së për shkak të një force madhore, vlerëson që deklarata e forcës madhore është e pajustifikueshme, ajo mund t’ia referojë çështjen ERE-s për rishikimin e deklaratës ose Gjykatës.

9.4 Nëse ERE konstaton se arsyet për mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Rregullore nuk janë shkaktuar nga një Forcë Madhore dhe procesi i apelimit e ka pohuar atë konstatim, detyrimet e OSSH-G-së nuk do të konsiderohen të pezulluara për periudhën e pretenduar.



PJESA III
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 10
Dispozita kalimtare

Afati kohor për zbatimin e Treguesve të Performancës Minimale të Cilësisë.

10.1 Vlerat fillestare të MQPS-së jepen në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje. Ato sigurojnë nivele indikative, por jo të detyrueshme që duhet të synohen nga OSSH-ja gjatë një periudhe tranzitore dy vjeçare duke filluar nga janari i vitit 2020. MQPS-ja do të rivlerësohet nga ERE në bazë të performancës së demonstruar gjatë periudhës tranzitore dhe gjendjes së përgjithshme të sektorit të gazit natyror.

10.2 OSSH-G nuk do të jetë subjekt i një gjobe për shkak të mosrealizimit në përputhje me MQPS-në fillestare, para 31 dhjetorit 2022, siç parashikohet në nenin 8.

10.3 OSSH-G-ja do t'i paraqesë ERE-s gjashtë muaj para përfundimit të periudhës tranzitore (30 qershor 2021) një propozim për MQPS-në të cilën ERE do të rishikojë në përputhje me “Rregullat e organizimit, funksionet dhe procedurat e ERE-s”. Pas miratimit nga ERE ato do të bëhen të detyrueshëm për zbatimin nga OSSH-G-ja për periudhën e ardhshme dhe çdo nën-performancë do të jetë subjekt i nenit 8.

10.4 Jo më herët se në nëntor 2023 OSSH-G-ja mund të paraqesë në ERE një propozim për Skemën e Nxitjes së Performancës së Cilësisë me qëllim shpërblimin e OSSH-G-së dhe të

licencuarve të tjerë në sektorin e gazit për përmirësimin e performancës së cilësisë së shërbimeve dhe furnizimit. Niveli i performancës duhet të vlerësohet kundrejt MQPS-së të parashikuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje, ndërkohë që niveli i stimuljeve duhet të pasqyrojë përvojën më të mirë nga Palët Kontraktore të komunitetit të energjisë.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind si rezultat i moszbatimit të kësaj rregulloreje, do të trajtohet nga ERE në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”.

Neni 12
Rishikimi dhe amendimi

Kjo rregullore mund të rishikohet dhe/ose të amendohet vetëm nëpërmjet një vendimi të Bordit të ERE-s.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare



SHTOJCA 1
STANDET E PERFORMANCËS MINIMALE TË CILËSISË

Standardet Fillestare të Performancës Minimale të Cilësisë së Shërbimit dhe Furnizimit me gaz natyror që duhet të përmbushë OSSh-ja

	Indikatori i Performancës së Cilësisë	Përshkrimi	Njësia	Niveli i pritshëm i performancës	Dokumenti rregullator i referencës	Niveli referencë i parametrave
1	Indeksi i rrezikut të rrjedhjeve të gazit	Nr. i rrjedhjeve të gazit të raportuara nga palët e treta		në rënie	Kjo Rregullore	
2	Efikasiteti i reagimit ndaj thirrjeve emergjente në lidhje me rrjedhjet e gazit	Numri i rasteve që OSSh-ja arrin në vendngjarje brenda 90 minutave nga njoftimi	%	Jo më pak se 95%		
3	Përqindja e klientëve me Lexim Faktik të Matjes	$MC(\%) = \left(1 - \frac{NMC}{CB}\right) * 100\%$	%	Jo më pak se 97%		
4	Performanca e njoftimit për ndërprerjet e planifikuara	$PPI(\%) = \left(1 - \frac{NNPI}{TPI}\right) * 100\%$	%	Jo më pak se 95%	Kodi i Rrjetit	5 ditë kalendarike para njoftimit për çdo ndërhyrje të planifikuar mirëmbajtje, riparimi ose tjetër
5	Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes së sistemit (SAIDI)	$SAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K (Di \times Ni)}{CB}$				
6	Indeksi i Frekuencës Mesatare të Ndërprerjes së Sistemit (SAIFI)	$SAIFI = \frac{K}{CB}$				
7	Indeksi i kohëzgjatjes mesatare së ndërprerjes për klientin (CAIDI)	$CAIDI = \frac{\sum_{i=1}^K Di \times Ni}{K} = \frac{SAIDI}{SAIFI}$				



8	Indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjes për klientin (CAIFI)	$\text{CAIFI} = \frac{\text{Nr. tot. i ndërprerjeve të vazhdueshme}}{\text{Nr. i klientëve të prekur}}$				
9	Indeksi i Performancës në përgjigjen ndaj ankesave të klientëve (PICC)	$\text{PICC}(\%) = \left(1 - \frac{\text{NRC}}{\text{TNC}}\right) * 100\%$	%		Standardet e Trajtimit të Ankesave të Klientëve nga të Licencuarit në aktivitetet e Shpërndarjes dhe Furnizimit me Gaz Natyror	
10	Indeksi i Performancës në zgjidhjen e ankesave lidhur me cilësinë e presionit (PIPQ)	$\text{PIPQC}(\%) = \left(1 - \frac{\text{NNFPQC}}{\text{TNPQC}}\right) * 100\%$			Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes Rregullore Teknike	
11	Indeksi i Performancës në Zgjidhjen e Kërkesave të Klientit për Lidhje të Re (PINC)	$\text{PINC}(\%) = \left(1 - \frac{\text{NDNC}}{\text{TRNC}}\right) * 100\%$	%		Kodi i Rrjetit ose Rregullore për Lidhjet e Reja	

**KËRKESË**

Shtetasja Agllaça Janila kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të humbur dhe të vdekur të shtetasit Jani Janila, i datëlindjes 7.2.1916.

KËRKUESE
Agllaça Janila

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë